



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1181/13 prot.

Tiranë më 19.06.2026

U R D H Ë R

Nr. 138, datë 19.06.2026

PËR KONTROLLUESIN “ZYRA E GJENDJES CIVILE, BASHKIA TIRANË”

Në mbështetje të neneve 15, 82, 83, 84 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Zyrës së Gjendjes Civile, Bashkia Tiranë” (në vijim, “Kontrolluesi/ZGJC, Bashkia Tiranë”),

KONSTATOVA SE:

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”), ka administruar ankesën e znj. nr. 1181 prot., datë 28.4.2026, nëpërmjet të cilës ankuesja pretendon se ka paraqitur kërkesë pranë Zyrës së Gjendjes Civile pranë Bashkisë Tiranë për korrigjimin e rubrikës “datëlindja” nga “20.7.1999”, e pasaktë, në atë të saktë “29.7.1999”, por nuk ka marrë zgjidhje lidhur me këtë pretendim.

Pas administrimit të ankesës, Zyra e Komisionerit shqyrtoi dokumentacionin e bashkëlidhur saj, konkretisht: certifikatën e asistencës së lindjes nr. 0000526; certifikatën familjare të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative nr. 2; certifikatën e martesës (nga akti), të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative nr. 2; certifikatën e lindjes të lëshuar nga Njësia Administrative nr. 2; si dhe certifikatën e lindjes të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile (Arkivi), Bashkia Tiranë. Nga shqyrtimi krahasimor i dokumentacionit rezulton se në të gjitha dokumentet e sipërcituara datëlindja e ankueses pasqyrohet saktë si “29.7.1999”, me përjashtim të certifikatës së lindjes të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile (Arkivi), Bashkia Tiranë, e cila rezulton të jetë i vetmi dokument ku datëlindja e ankueses është pasqyruar si “20.7.1999”.

Në vijim të administrimit të ankesës dhe shqyrtimit paraprak të dokumentacionit të bashkëlidhur saj, me qëllim verifikimin e plotë të rrethanave të pretenduara dhe administrimin e dokumentacionit përkatës nga autoritetet përgjegjëse, Zyra e Komisionerit ka urdhëruar kryerjen e hetimit administrativ pranë organeve kompetente të gjendjes civile.

Konkretisht, përmes Urdhrit nr. 98, datë 11.5.2026, është urdhëruar kryerja e hetimit administrativ pranë kontrolluesit “Zyra e Gjendjes Civile pranë Bashkisë Tiranë (Arkivi)”; përmes Urdhrit nr. 99, datë 11.5.2026, është urdhëruar kryerja e hetimit administrativ pranë “Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile”; si dhe përmes Urdhrit nr. 104, datë 13.5.2026, është urdhëruar kryerja e hetimit administrativ pranë “Zyrës së Gjendjes Civile pranë Njësisë Administrative nr. 2”.

Nga hetimi administrativ i zhvilluar pranë Kontrolluesit/ZGJC, Bashkia Tiranë, u konstatua se në regjistrin ku pasqyrohen të dhënat e aktit të lindjes, datëlindja e ankueses rezulton e regjistruar si “20.7.1999”, ndërkohë, nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ pranë Zyrës së Gjendjes Civile pranë Njësisë Administrative nr. 2 (në vijim “Kontrolluesi/ZGJC, Njësia Administrative nr. 2”), rezulton se të dhënat e ankueses në Regjistrin Themeltar të Shtetasve, konkretisht rubrika “datëlindja”, janë pasqyruar si “29.7.1999”, në përputhje me certifikatën e asistencës së lindjes nr. 0000526, e cila përbën edhe dokumentacionin bazë mbi të cilin mbështetet regjistrimi i lindjes.

Për rrjedhojë, nga grupi i hetimit u konstatua cenimi i parimit të saktësisë së të dhënave personale, të parashikuar nga neni 6, pika 4, i Ligjit, sipas të cilit të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe, kur është e nevojshme, të përditësuara, si dhe kontrolluesi duhet të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për korrigjimin e menjëhershëm të të dhënave të pasakta ose të paplota. Njëkohësisht, u konstatua mosgarantimi efektiv i të drejtës së subjektit të të dhënave për korrigjimin e të dhënave personale të pasakta, të parashikuar nga neni 15 i Ligjit.

Në vijim të procedurës administrative, në datën 02.06.2026 u zhvillua seanca dëgjimore me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të organeve të gjendjes civile. Gjatë kësaj seance, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile paraqiti edhe pretendimet e saj me shkrim, të administruara në dosjen administrative të çështjes.

- i. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile parashtroi se data e lindjes “20.07.1999”, e pasqyruar në aktin e lindjes së ankueses, rezulton të jetë regjistruar mbi bazën e deklarimeve të kryera në momentin e regjistrimit të lindjes dhe se, pas hartimit, nënshkrimit dhe arkivimit të aktit të lindjes, nuk mund të kryhen korrigjime apo saktësime të mëtejshme administrative në përmbajtjen e tij. Gjithashtu, u pretendua se dokumenti “asistencë në lindje” i paraqitur nga ankuesja përbën një dublikatë të lëshuar nga institucioni shëndetësor dhe jo dokumentin autentik të përdorur në momentin e regjistrimit

- të lindjes, ndaj nuk mund të provohet me siguri se ky dokument është ai mbi bazën e të cilit është mbajtur akti i lindjes.
- ii. Akti i lindjes përbën dokument zyrtar të arkivuar, i hartuar nga nëpunësi i gjendjes civile në ushtrim të kompetencave ligjore dhe, si i tillë, nuk mund të ndryshohet apo modifikohet administrativisht pas arkivimit. Sipas këtij qëndrimi, edhe në rastet kur konstatohet *prima facie* ekzistenca e një pasaktësie në përmbajtjen e aktit, verifikimi i pavërtetësisë ose pasaktësisë së tij mund të realizohet vetëm në rrugë gjyqësore, në përputhje me nenin 32 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 43 të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar.
 - iii. Nga verifikimet e kryera, konstatohet *prima facie* se e dhëna e datëlindjes në aktin e lindjes rezultojnë të jetë pasqyruar gabim, por deklaroi se kjo pasaktësi nuk mund të korrigjohet në rrugë administrative përmes ndërhyrjes në përmbajtjen e aktit të lindjes të arkivuar. Sipas këtij qëndrimi, pasaktësia e aktit mund të konstatohet dhe të kundërshtohet vetëm nëpërmjet procedurave gjyqësore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
 - iv. Procedurat administrative të korrigjimit të gabimeve materiale të parashikuara nga legjislacioni i gjendjes civile lidhen me korrigjimin e të dhënave të transkriptuara gabim në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe jo me ndryshimin e përmbajtjes së aktit të lindjes të arkivuar. Megjithatë, duke pranuar ekzistencën e gabimit në pasqyrimin e datëlindjes së ankueses, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile shprehu gatishmërinë për trajtimin administrativ të rastit nëpërmjet lëshimit të një vërtetimi administrativ, në të cilin të konfirmohet ekzistenca e gabimit në aktin e lindjes dhe data e saktë e lindjes së ankueses.

Zyra e Komisionerit, pasi mori në shqyrtim gjetjet e hetimit administrativ, dokumentacionin e administruar në dosjen e çështjes, si dhe pretendimet e paraqitura nga kontrolluesi gjatë seancës dëgjimore të datës 02.06.2026 dhe me shkrim, vlerëson se për zgjidhjen e drejtë të çështjes objekt shqyrtimi është e nevojshme të analizohet kuadri ligjor i zbatueshëm, si në aspektin e legjislacionit që rregullon administrimin e të dhënave të gjendjes civile, ashtu edhe në aspektin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Në këtë kuadër, pretendimet e kontrolluesit lidhur me natyrën juridike të pasaktësisë së konstatuar dhe procedurën e korrigjimit të saj duhet të vlerësohen në raport me dokumentacionin provues të administruar gjatë hetimit administrativ, si dhe me detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi për garantimin e saktësisë së të dhënave personale.

Në analizë të kuadrit ligjor të zbatueshëm, rezultojnë se neni 6 pika 1 i ligjit nr. 10129/2009 “Për Gjendjen Civile”, i ndryshuar, parashikon se datëlindja përbën një ndër përbërësit themelorë të gjendjes civile të shtetasit, ndërsa neni 4 i këtij ligji parashikon vlefshmërinë juridike të të dhënave të gjendjes civile vetëm kur ato lëshohen dhe administrohen sipas formës dhe procedurës së parashikuara nga ligji. Në këtë kuptim, ligji për gjendjen civile ndërton një regjim juridik të bazuar mbi saktësinë, autenticitetin dhe besueshmërinë e të

dhënave të regjistruara, pasi këto të dhëna shërbejnë për identifikimin juridik të individit dhe prodhojnë pasoja të drejtpërdrejta në marrëdhëniet juridike publike dhe private.

Në të njëjtën kohë, nga interpretimi sistematik i dispozitave të ligjit nr. 10 129/2009 “*Për Gjendjen Civile*”, i ndryshuar, dhe veçanërisht i neneve 27, 38 dhe 42 të tij, rezulton se akti i lindjes mbahet mbi bazën e dokumentacionit provues të administruar nga shërbimi i gjendjes civile, konkretisht mbi bazën e deklaramit të lindjes dhe dokumenteve që provojnë faktin e lindjes. Neni 38 i këtij ligji parashikon rëndësinë e dokumentacionit mbi të cilin mbështetet regjistrimi i lindjes, ndërsa neni 42 përcakton përmbajtjen e detyrueshme të aktit të lindjes, ku përfshihet edhe data e plotë e lindjes.

Për më tepër, nga vetë struktura dhe funksioni juridik i regjistrimit të lindjes rezulton se të dhënat e aktit të lindjes duhet të përputhen me të dhënat e pasqyruara në certifikatën e asistencës së lindjes, e cila përbën dokumentin bazë mjekësor që provon faktin dhe momentin e lindjes. Në këtë drejtim, nuk mund të pranohet pretendimi i kontrolluesit se certifikata e asistencës së lindjes e paraqitur nga ankuesja nuk mund të merret në konsideratë për shkak se është lëshuar në formë dublikate. Fakti që dokumenti është lëshuar në formë dublikate nuk cenon natyrën e tij si dokument zyrtar dhe as vlerën e tij provuese, për sa kohë ai është lëshuar nga autoriteti kompetent dhe pasqyron të njëjtën ngjarje juridike, konkretisht lindjen e subjektit të të dhënave. Për rrjedhojë, mungesa e dokumentit origjinal të përdorur në momentin e regjistrimit të lindjes nuk cenon vërtetësinë e të dhënave të pasqyruara në dokumentin zyrtar të lëshuar nga institucioni shëndetësor. Përkundrazi, në kushtet kur data “29.07.1999” rezulton e reflektuar edhe në Regjistrin Themeltar të Shtetasve, pasqyrimi i datës “20.07.1999” në regjistrin e aktit të lindjes pranë arkivit të gjendjes civile përbën një mospërputhje materiale me dokumentacionin bazë mbi të cilin duhet të ishte mbajtur akti i lindjes.

Lidhur me pretendimin e kontrolluesit se ankuesja duhet t’i drejtohet gjykatës për korrigjimin e datëlindjes së pasqyruar në aktin e lindjes, Zyra e Komisionerit vlerëson se ky pretendim nuk qëndron në rrethanat konkrete të çështjes. Ndërhyrja e gjykatës mund të paraqitet e nevojshme në ato raste kur ekziston pasiguri, mungesë provash ose mosmarrëveshje mbi faktin juridik që kërkohet të vërtetohet, përfshirë rastet kur nuk është e mundur të përcaktohet me siguri data e lindjes së një personi ose kur dokumentacioni përkatës paraqet mospërputhje të tilla që kërkojnë vlerësim gjyqësor. Në rastin konkret nuk ndodhemi përpara një situate të tillë.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ rezulton në mënyrë të qartë dhe të njëtrajtshme se datëlindja e ankueses është “29.07.1999”, e provuar nga certifikata e asistencës në lindje, Regjistri Themeltar i Shtetasve dhe dokumentet e tjera zyrtare të administruara në dosje. Për më tepër, edhe vetë kontrolluesi ka pranuar ekzistencën e gabimit në pasqyrimin e datëlindjes në aktin e lindjes. Në këto kushte, nuk jemi përpara nevojës për të vërtetuar gjyqësisht një fakt juridik të paqartë apo të kontestuar, por përpara nevojës për të korrigjuar administrativisht një pasaktësi materiale të provuar nga dokumentacioni zyrtar.

Në analizë të natyrës juridike të kësaj mospërputhjeje, rezulton se gabimi në rastin konkret përbën gabim material, objektivisht të verifikueshëm dhe të kufizuar vetëm në pasqyrimin e datëlindjes së ankueses në regjistrin e aktit të lindjes pranë arkivit të gjendjes civile.

Kjo mospërputhje nuk përbën ndryshim të faktit juridik të lindjes dhe as kontestim të identitetit civil të ankueses, por një gabim material në transkriptimin dhe pasqyrimin e datës në aktin përkatës. Në kuptim juridik, gabimi material karakterizohet nga fakti se ai është i dukshëm nga krahasimi i akteve, nuk kërkon vlerësim të ri mbi gjendjen civile të personit dhe nuk sjell krijimin, ndryshimin apo shuarjen e një statusi juridik, për rrjedhojë, korigjimi në rastin konkret nuk synon të ndryshojë datëlindjen e ankueses si fakt juridik, por vetëm të harmonizojë aktin e lindjes me të dhënën e provuar nga dokumentacioni bazë dhe regjistrat themeltarë të gjendjes civile.

Ligji nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim “Ligji”) gjen zbatim të drejtpërdrejtë në rastin konkret, për sa kohë datëlindja përbën “të dhënë personale”, ndërsa administrimi i saj nga organet e gjendjes civile përbën “përpunim” të të dhënave personale, sipas përkufizimeve të nenit 5 pikat 3 dhe 16 të Ligjit.

Neni 6 pika 4 i Ligjit parashikon parimin e saktësisë së të dhënave personale, sipas të cilit të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe të përditësuara, si dhe kontrolluesi duhet të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për korigjimin e menjëhershëm të të dhënave të pasakta ose të paplota. Në të njëjtën linjë, neni 15 i Ligjit i njuh subjektit të të dhënave të drejtën për të kërkuar korigjimin e të dhënave personale nga kontrolluesi, sa më shpejt të jetë e mundur, kur këto të fundit janë të pasakta/paplota.

Në rastin konkret, ankuesja legjitimohet plotësisht për të kërkuar korigjimin e të dhënës së pasqyruar gabim në aktin e lindjes, për sa kohë kjo e dhënë lidhet drejtpërdrejt me identitetin e saj civil dhe provohet në mënyrë të pakundërshtueshme nga dokumentacioni zyrtar i administruar.

Nga pikëpamja doktrinare, Ligji 124/2024 përbën ligjin special në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe garantimit të të drejtave të subjektit të të dhënave ndaj çdo forme përpunimi të të dhënave personale nga autoritetet publike ose subjektet private, ndërsa ligji “Për Gjendjen Civile” rregullon organizimin dhe administrimin e regjistrave civilë.

Ligji nr. 124/2024 garanton standardet e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale, përfshirë saktësinë e tyre dhe të drejtën e subjektit për korigjim, për rrjedhojë, këto dy akte ligjore nuk qëndrojnë në raport përjashtues, por në raport plotësues me njëri-tjetrin.

Në zbatim të parimit “*lex specialis derogat legi generali*”, dispozitat e Ligjit mbi të drejtën për korigjimin e të dhënave personale dhe kompetencat mbikëqyrëse të Komisionerit gjejnë zbatim të drejtpërdrejtë në rastin konkret, pasi objekti i shqyrtimit

lidhet pikërisht me saktësinë e një të dhëne personale të përpunuar nga administrata publike.

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit, në cilësinë e autoritetit mbikëqyrës për garantimin e zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, ka kompetencën të shqyrtojë ankesat e subjekteve të të dhënave dhe, në rast konstatimi të cenimit të parimit të saktësisë së të dhënave personale, të urdhërojë kontrolluesin për marrjen e masave korrigjuese të nevojshme.

Sa më sipër, për sa kohë provohet se pasaktësia lidhet vetëm me regjistrin e aktit të lindjes pranë arkivit të gjendjes civile dhe jo me të dhënat e regjistruara në Regjistrin Themeltar të Shtetasve, rezulton i mbështetur në ligj urdhërimi i korrigjimit të kësaj pasaktësie materiale.

Lidhur me mënyrën e realizimit të korrigjimit, vlerësohet se, për shkak të natyrës së aktit të lindjes si dokument arkivor i gjendjes civile, mbi aktin origjinal nuk mund të kryhen ndërhyrje materiale, fshirje apo mbivendosje shënimesh që cenojnë integritetin formal dhe autenticitetin e tij.

Për këtë arsye, korrigjimi duhet të realizohet nëpërmjet nxjerrjes së urdhrit përkatës të korrigjimit administrativ, i cili i bashkëlidhet fletës së aktit të lindjes si pjesë përbërëse e dokumentacionit administrativ të gjendjes civile, me qëllim evidentimin zyrtar të korrigjimit të kryer dhe garantimin e gjurmueshmërisë administrative të ndërhyrjes. Njëkohësisht, organi përgjegjës duhet të kryejë reflektimin e korrigjimit në sistemin elektronik të administrimit të të dhënave të gjendjes civile, në mënyrë që çdo dokument apo ekstrakt i gjeneruar në vijim të pasqyrojë datëlindjen e saktë të subjektit të të dhënave.

Një mënyrë e tillë korrigjimi është në përputhje me parimin e saktësisë së të dhënave personale, të parashikuar nga neni 6 pika 4 i Ligjit, si dhe me detyrimin e administratës për të garantuar integritetin, besueshmërinë dhe harmonizimin e të dhënave të gjendjes civile.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 15, 82, 83 pika 2, germa “e” të Ligjit,

URDHËROJ :

1. Kontrolluesi “*Zyra e Gjendjes Civile, Bashkia Tiranë (Arkivi)*”, të realizojë korrigjimin në rubrikën “*datëlindja*” nga “*20.7.1999*” në “*29.7.1999*”, në aktin e lindjes që i përket znj. Artea Beberi, sipas pjesës arsyetuese të këtij urdhri.
2. Kontrolluesi “*Zyra e Gjendjes Civile, Bashkia Tiranë (Arkivi)*”, të informojë subjektin e të dhënave personale znj. _____, për korrigjimin e të dhënave personale.

3. Kontrolluesi “Zyra e Gjendjes Civile, Bashkia Tiranë (Arkivi)”, mbart detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit, lidhur me zbatimin e detyrave të lëna në këtë urdhër, brenda 30 ditëve.
4. Afati i sipërpërmendur, fillon nga data e marrjes dijeni të këtij akti.
5. Në rast të moszbatimit të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas neneve 92, 93 dhe 94 të Ligjit, për vendosjen e sanksioneve administrative në përputhje me nenet përkatëse, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative, në mënyrë të tillë që këto masa të jenë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues.

Ky Urdhër u shpall sot më datë 19.06.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi